

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7104  
E martë, 30 janar 2024  
Çmimi 0.50 €

Kosova dhe Turqia  
nënshkruajnë marrëveshje  
ushtarake | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-SË  
SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (24)

## "ME PAGESË" OSE "PA PAGESË", TË GJITHË ATA QË PRETENDOJNË SE NË KOSOVË NUK KA PASUR SHQIPTARË PËRPARA PUSHTIMIT NGA PERANDORIA OSMANE JANË ARGATË TË SERBISË.

 | FAQE 4-5

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë "Epokës së re", në

vazhdimin e pjesës së njëzet e katër, ka folur lidhur me mohimin e pranisë së shqiptarëve në Kosovë përpara pushtimit nga Perandoria Osmane. Ai

ka theksuar se ata që pretendojnë se në Kosovë nuk ka pasur shqiptarë përpara pushtimit nga Perandoria Osmane janë argatë të Serbisë

**TALAT XHAFERI  
MERR DETYRËN  
E KRYEMINISTRIT  
TEKNIK TË  
MAQEDONISË  
SË VERIUT** | F. 3



**PËRKUJTOHET  
MASAKRA NË  
ROGOVË TË HASIT:  
KOSOVA NUK  
I HARRON E AS  
NUK I FAL KRIMET  
E KRYERA  
NGA SERBIA** | F. 5



### OPINION

**ALI AHMETI DUHET TË  
PËRKRAHET NGA TË GJITHË  
SHQIPTARËT KUDO  
QË JETOJNË** | F. 7

Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA



### AKTUALE



**BUJOIT FRANCEZË E RRETHOJNË  
PARISIN ME TRAKTORË** | F. 2

**SBASHK-U VAZHDON PËRGATITJET  
PËR KONFERENCËN PËR SHËNDETIN  
MENDOR NË SHKOLLA** | F. 7

### EKONOMI



**HOVENIERI I KËRKON GUVERNATORIT  
TË BOK-SË TA SHITYJË ZBATIMIN E  
VENDIMIT PËR DINAR** | F. 8

**KEDS-I ZVOGËLON HUMBJET NË  
RRJET NË 15,32 %** | F. 8

### SPORT



**SHUMË YJET PRITET TË LARGOHEN  
NGA SUPERLIGA** | F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## IS-i merr përgjegjësinë për sulmin në kishën në Stamboll

**STAMBOLL, 29 JANAR** - Grupi militant Shteti Islamik (IS) ka marrë përgjegjësinë për sulmin në një kishë katolike romake në Stamboll, ku u vra një person. Sulmi ndodhi të dielën, më 28 janar, gjatë një shërbese. Grupi ekstremist tha përmes një deklarate se ka kryer "sulm në një tubim të pafeve të krishterë gjatë një ceremonie të tyre politeiste" në Kishën e Shën Marisë në lagjen Bujukdere të Stambollit. Ministri i Brendshëm i Turqisë, Ali Yerlikaya, tha në orët e vona të së dielës se dy persona, që ai tha se ishin anëtarë të IS-it, janë arrestuar lidhur me sulmin. Sipas tij, njëri është nga Taxhikistani,

tjetri nga Rusia. Deklarata përmes së cilës IS-i mori përgjegjësinë për sulmin u publikua në Aamaq, krahun mediatik të IS-it, së bashku me fotografitë e dy persona të maskuar e të armatosur, të cilët, sipas grupit militant, kryen sulmin. IS-i tha se në sulm u vra një person dhe u plagos një tjetër, por autoritetet turke kanë deklaruar se një person është vrarë, por nuk ka të plagosur të tjerë. Yerlikaya tha se policia ka bastisur 30 lokacione dhe ka arrestuar 47 persona si pjesë e hetimit për këtë sulm. "Asnjëherë nuk do të tolerojmë ata që tentojnë ta

pengojnë paqen në shtetin tonë", tha ministri turk.

Më 3 janar, 25 anëtarë të dyshuar të IS-it u arrestuan në mbarë Turqinë, nën dyshimet se kishin planifikuar sulme ndaj kishave dhe sinagogave, ka raportuar agjencia shtetërore e lajmeve "Anadolu".

IS-i në të kaluarën nuk kishte kryer sulme ndaj faltoreve në Turqi, por ka kryer një sërë sulmesh vdekjeprurëse në mbarë vendin, përfshirë edhe një sulm në një klub nate më 2017 në Stamboll, kur u vranë 39 persona. IS-i, po ashtu, ka kryer një sulm me bombë më 2015 në Ankara, duke vrarë 109 persona.



## Bujqit francezë e rrethojnë me traktorë Parisin

**PARIS, 29 JANAR** - Bujqit francezë e kanë rrethuar të hënën Parisin duke i vendosur traktorët si barrikadë dhe duke vozitur ngadalë, në përpjekje për ta shtuar trysinë ndaj qeverisë franceze për të ardhmen e industrisë së tyre, e cila ka marrë goditje të rëndë nga pasojat e luftës në Ukrainë. Ata i përdorin automjetet e tyre të rënda dhe të ngadalshme për t'i bllokuar autostradat që çojnë drejt kryeqytetit francez.

Protesta në Paris - nikoqirin e Lojërave Olimpikë Verore pas gjashtë muajve si dhe protestat në qytetet e tjera franceze, bëjnë që kryeministri i ri, Gabriel Attal, të përballet me një javë të vështirë një muaj pasi e mori detyrën.

Attal nuk ia doli t'i ndalë protestat e bujqve, megjithëse mori masa në favor të bujqësisë javën e kaluar, pasi bujqit i cilësuan ato si të



pamjaftueshme për kërkesat e tyre që prodhimi i ushqimit duhet të jetë më fitimprurës, më i lehtë dhe më i drejtë.

Protestuesit u përgjigjën me

zhvendosjen e qindra traktorëve, rimorkiove dhe madje kombajnave për ta bllokuar dhe ngadalësuar komunikacionin, duke e përshkruar këtë si "rrethim"

për ta shtyrë qeverinë e Attalit të lëshojë pe.

Disa protestues mbërritën me rezerva ushqimi dhe uji si dhe tenda për të qëndruar pranë barrikadave nëse qeveria nuk i plotëson kërkesat e tyre.

Protestuesit thanë se ndihen të shpërfillur nga ministrat qeveritarë, të cilët i akuzuan se rrallëherë guxojnë t'i vizitojnë bujqit dhe t'i baltosin këpuçet e tyre.

Qeveria njoftoi se i ka zhvendosur 15 000 zyrtarë policorë, kryesisht në rajonin e Parisit, për të mos lejuar futjen e protestuesve në kryeqytet.

Në disa prej autostradave që i bllokuan, protestuesit vendosën në traktorët e tyre afishe me mbishkrimin: "Pa bujq nuk ka ushqim", dhe "Fundi ynë nënkupton krizë urie për ju".

"Synimi ynë nuk është ta shqetësojmë apo rrënojmë jetën e popullit francez", tha Arnaud Rousseau, president i shoqatës bujqësore me ndikim, FNSEA. "Synimi ynë është t'i bëjmë trysni qeverisë që sa më shpejt ta gjejë një zgjidhje për krizën tonë", shtoi ai për radion RTL.

Protestat në Francë janë dëshmi shtesë për krizën ushqimore në gjithë botën, e cila është përkeqësuar nga lufta mbi dyvjeçare e Rusisë në Ukrainë, vendi i cili është prodhues i madh i ushqimit.

Bujqit francezë ngulin këmbë se rritja e çmimeve të plehut, rrymës dhe gjërave të tjera të nevojshme për rritjen e të mbjellave dhe ushqyerjen e bagëtive, ua kanë harxhuar të hyrat, duke e bërë të pamundshme marrjen me bujqësi për shumë prej tyre.

## Putini zyrtarisht regjistrohet kandidat për zgjedhjet presidenciale



**MOSKË, 29 JANAR** - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Rusi ka regjistruar presidentin aktual, Vladimir Putin, kandidat për zgjedhjet e reja presidenciale.

Putini do të garojë për mandatin e pestë presidencial. Për shkak të ndryshimeve kushtetuese, që janë kritikuar nga ekspertët, Putini ka të drejtë të bëhet president edhe për dy mandate. Për herë të parë ai u

zgjodh president i Rusisë në vitin 2000.

Putini do të garojë si kandidat i pavarur në zgjedhjet e caktuara për 17 mars. Për t'u regjistruar kandidat, atij iu kërkua të mbledhte të paktën 300 000 nënshkrime të rusëve nga rajone të ndryshme të shtetit për ta mbështetur kandidaturën e tij. Nga nënshkrimet e dorëzuara, 0.15 për

qind e tyre u shpallën të pavlefshme nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Rusi.

Gjatë mbledhjes së nënshkrimeve për Putinin u evidentuan një sërë shkeljesh. Në veçanti në Shën Petersburg nënshkrimet u mbledhën nga anëtarët e komisionit të zonës, që drejtpërdrejt përbën shkelje të ligjit. Putini është bërë kandidati i katërt i

regjistruar për zgjedhjet presidenciale ruse, pas Vladislav Davankovit nga partia Populli i Ri, Nikolai Kharitonovit nga Partia Komuniste dhe Leonid Slutskiyt nga Partia Liberale Demokratike. Në përgjithësi, 11 kandidatë po synojnë të garojnë në zgjedhje dhe kandidatët kanë afat t'i mbledhin nënshkrimet e nevojshme deri më 31 janar.

## Pentagoni: Grupet e mbështetura nga Irani, përgjegjëse për sulmin ndaj trupave amerikane

**UASHINGTON, 29 JANAR** - Presidenti Joe Biden ka theksuar se Uashingtoni do t'i përgjigjet vrasjes së tre ushtarëve amerikanë në një bazë në Jordani pa dhënë detaje mbi këtë çështje. Ngjarja ndodhi në fundjavë në një bazë amerikane pranë kufirit Jordani - Siri dhe krahas ushtarëve të vrarë, u

plagosën edhe mbi 30 ushtarë të tjerë. Teherani ka hedhur poshtë akuzat se ka nxitur sulmin. Republikanët në Kongresin amerikan kanë kërkuar reagim të ashpër ndaj republikës islamike. Komanda Qendrore e ushtrisë amerikane tha se tre ushtarë u vranë dhe të paktën 34 persona u plagosën, një

numër që mund të ndryshojë. Kjo bazë në Jordaninë verilindore gjendet pranë kufirit me Sirinë.

Ky është sulmi i parë vdekjeprurës kundër forcave amerikane që nga nisja e luftës Izrael - Hamas, që shpërtheu në tetor dhe rrezikon ta përfshijë gjithë rajonin.



# Talat Xhaferi merr detyrën e kryeministrit teknik të Maqedonisë së Veriut

SHKUP, 29 JANAR - Kryeministri teknik i Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, ka marrë zyrtarisht të hënën detyrën nga paraardhësi i tij, Dimitar Kovaçevski.

Qeveria teknike do të funksionojë për 100 ditë dhe do të ketë mandat për organizimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve parlamentare më 8 maj.

Pas marrjes së detyrës së re, Xhaferi tha se do të bëjë gjithçka "për të punuar në të mirë të vendit dhe të qytetarëve". Ai tha se kabineti teknik do ta vazhdojë punën për realizimin e programit të qeverisë së deritanishme të Kovaçevskit. "Nuk ka dyshim se detyrë parësore e kësaj qeverie është përgatitja dhe organizimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, demokratike në një procedurë të hapur dhe ligjore të drejtpërdrejtë dhe bashkëpunim me Kuvendin. Qeveria do t'i zbatojë të gjitha parakushtet ligjore për t'i mundësuar standardet më të larta evropiane në fushatën elektorale dhe mbajtjen e tyre bazuar në vullnetin e qytetarëve", u shpreh Xhaferi në një paraqitje para medieve së bashku me ish-kryeministrin Dimitar Kovaçevski. Xhaferi tha se prioritet i qeverisë teknike do të jetë edhe "realizimi i politikave për zhvillim ekonomik, ruajtja dhe avancimi i standardit të qytetarëve", si dhe vazhdimi i procesit të integrimit të Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian. "Ruajtja dhe avancimi i partneritetit strategjik të Maqedonisë së Veriut me BE-në,

me NATO-n dhe Shtetet e Bashkuara si qëllime strategjike që nga pavarësia e shtetit, mbeten prioritet parësor të kësaj qeverie. Kjo edhe për faktin duke marrë parasysh zhvillimet gjeopolitike, pasi lëkundja apo mospasja e orientimit të qartë evropian mund të shfrytëzohet nga shtete të treta për ta destabilizuar vendin përmes shtrirjes së ndikimit këtu dhe në rajon", tha ai.

Pjesë e qeverisë teknike është edhe partia opozitare maqedonase VMRO DPMNE, e cila në kabinetin e Xhaferit do ta drejtojë Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe ka edhe tre zëvendësministra me kompetenca të veçanta.

Pavarësisht se është pjesë e qeverisë, VMRO DPMNE-ja të dielën, më 28 janar, nuk votoi për ekzekutivin teknik. Kjo parti edhe të hënën doli me akuza për personalitetin e Xhaferit të Bashkimit Demokratik për Integrim, i cili e kishte nominuar për pozitën e kryeministrit. "Talat Xhaferi është sinonim i një politikani dhe një personi që nuk është i denjë të jetë në këtë vend. Ai është afërt me botën e krimit dhe një person që ka bërë shkelje të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën e Kuvendit derisa ishte kryetar i Kuvendit", u tha në reagimin e VMRO DPMNE-së.

Kjo parti akuzoi edhe Lidhjen Social Demokrate (LSDM) "për dëmtimin e interesave maqedonase".

"Besnikët e BDI-së dje [të dielën] e



bënë popullin maqedonas qiraxhi në vendin e tyre dhe lejuan që një parti që nuk ishte fituese e zgjedhjeve të zgjedhë kryeministër të vendit", tha VMRO-ja.

Për zgjedhjen e ekzekutivit votuan 65 deputetë, tre ishin kundër, abstenim nuk pati.

Për Bashkimin Demokratik për Integrim mbështetësit e këtij

subjekti, zgjedhja e Talat Xhaferit për drejtimin e qeverisë teknike, "është arritja më e madhe e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut".

## Përkujtohet masakra në Rogovë të Hasit: Kosova nuk i harron e as nuk i fal krimet e kryera nga Serbia

Prishtinë, 29 janar - Presidentja Vjosa Osmani, kryeministri Albin Kurti dhe liderët e opozitës kanë përkujtuar 25-vjetorin e masakrës në Rogovë të Hasit.

Osmani ka theksuar se më 27, 28 dhe 29 janar 1999 ndodhi një nga krimet më makabre në historinë e Kosovës - masakra e Rogovës së Hasit. "Forcat e regjimit gjenocidal të Millosheviqit sulmuan brutalisht fshatrat Rogovë të Hasit, Goden e Bishtazhin të Gjakovës dhe masakruan 9 civilë, teksa në altarin e lirisë ranë edhe 21 luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Nuk do t'i harrojmë asnjëherë jetët e pafajshme të marra në mënyrë brutale, sikurse edhe ata që ranë për lirinë tonë! Në përvjetorin e kësaj masakre, kërkesa për drejtësi është e domosdoshme në mënyrë që krime të tilla të mos përsëriten kurrë më! Qoftë i përhershëm kujtimi për dëshmorët dhe martirët e Rogovës së Hasit!", ka thënë Osmani.

Ndërkaq kryeministri Kurti ka thënë se përvjetorët na i përtërijnë

plagët e luftës. "Plagët e krimeve nuk vjetrohen. Republika e Kosovës nuk i harron e as nuk i fal krimet e kryera nga Serbia. Më 27, 28 dhe 29 janar të vitit 1999 forcat e armatosura serbe i vranë 30 shqiptarë në Rogovë të Hasit, Goden e Bishtazhin të Gjakovës. Në këtë 25-vjetor i përkujtojmë luftëtarët dhe civilët e rënë për liri, që me sakrificën e tyre e shtruan rrugën deri te çlirimi i Kosovës nga Serbia okupatore. Atëbotë ranë duke luftuar 21 ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe nëntë civilë shqiptarë", është shprehur Kurti.

Masakrën e Rogovës së Hasit e ka përkujtuar edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj. "Datat 27, 28 dhe 29 janar të vitit 1999 ishin të rënda për ecurinë tonë në luftën çlirimtare. Ato ditë, u përjetësuan shumë luftëtarë të zotë që unë i njoha në vijat e frontit, të cilët kishin marrë rrugë drejt kufirit me Shqipërinë që të sjellin armët e lirisë", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".





INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-së SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (24)

# "Me pagesë" ose "pa pagesë", të gjithë ata që pretendojnë se në Kosovë nuk ka pasur shqiptarë përpara pushtimit nga Perandoria Osmane janë argatë të Serbisë

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë "Epokës së re", në vazhdimin e pjesës së njëzet e katër, ka folur lidhur me mohimin e pranisë së shqiptarëve në Kosovë përpara pushtimit nga Perandoria Osmane. Ai ka theksuar se ata që pretendojnë se në Kosovë nuk ka pasur shqiptarë përpara pushtimit nga Perandoria Osmane janë argatë të Serbisë. "Ofensiva e gjithanshme për të mohuar çdo gjë shqiptare dhe për t'i paraqitur shqiptarët si krijesë e Perandorisë Osmane, që paraqet rrezik për Evropën, u bë në funksion të alarmimit të opinionit të vendeve perëndimore se gjoja 'shteti i pavarur i Kosovës do të ishte tempull i krimit të organizuar në zemër të Evropës që do të shndërrohen në një bazë për islamizimin e kontinentit'!!!", ka theksuar Bardhyl Mahmuti

**PRISHTINË, 29 JANAR-**  
**"Epoka e re":** Në disa shkrime që keni bërë lidhur me mohimin e pranisë së shqiptarëve në Kosovë përpara pushtimit nga Perandoria Osmane ju i keni cilësuar si "argatë të Serbisë" të gjithë ata që rreshtoheshin rreth kësaj teze. A mendoni se janë njerëz të paguar për këtë punë, sepse "argatllëku" paguhet?

**Bardhyl Mahmuti:** Të gjithë ata që përsërisin tezat serbe për t'i paraqitur shqiptarët pa histori të tyre, apo që mohojnë prejardhjen shqiptare të Gjergj

Kastriotit, Goxhe Bojaxhiut dhe personaliteteve të tjera të shquara të kombit tonë, me vetëdije, apo pa vetëdije, bëjnë punë në interes të strategjisë serbe. Në kuadër të kësaj kategorie hyjnë të gjithë ata "teologë", "historianë" dhe "publicistë" të fushave të ndryshme që me "zbulimet e tyre" përforcojnë pretendimet serbe. Nuk e di nëse janë të paguar apo jo, mirëpo "me pagesë" ose "pa pagesë", pa përjashtuar asnjë, të gjithë ata që pretendojnë se në Kosovë

nuk ka pasur shqiptarë përpara pushtimit nga Perandoria Osmane, janë argatë të Serbisë dhe të qarqeve antishqiptare!

**"Epoka e re":** Si e shihni faktin se kur flasim për atë periudhë historike, disa teologë dhe osmanologë hedhin poshtë termin pushtim?

**Bardhyl Mahmuti:** Është e njëjta frymë që synon shtrembërimin e realitetit historik dhe, për qëllime që nuk kanë asgjë të përbashkët me shkencën, pohojnë se gjoja Perandoria

Otomane nuk ka pasur ambicie pushtimit e tokave të huaja, por përhapjen e fesë islame! Madje shkohet deri aty sa të pohohet se gjoja "shqiptarët e kanë pritur ardhjen e Perandorisë Otomane siç e kemi pritur ardhjen e NATO-s në vitin 1999"!

**"Epoka e re":** Përveç teologëve dhe osmanologëve, në shkrimet e juaja përmendi edhe njerëz të fushave të tjera që u përfshinë në përhapjen e tezave të lartpërmendura... Për çfarë proflesh intelektuale bëhet

ffjalë?

**Bardhyl Mahmuti:** Po filloj me rastin e personit që mban emrin Kapllan, mbiemri i të cilit varej nga kontekstet ku ndodhej. Përpara se të bënte "hulumtime të shumta shkencore" që e prunë të përfundimi se "origjina e tij ishte serbe", ky alamet "shkencëtari" paraqitej si "Kapllan Kallushi", si "Kapllan Resuli" ose si "Kapllan Resulbegović". Mirëpo pas "zbulimit" se ishte "serb i islamizuar dhe shqiptarizuar", ai vendosi ta ndërronte mbiemrin

dhe të quhet Kapllan Burović. Përveç origjinës së vet serbe, “dr. Kapllan Burović”, që ia ka vënë vetes edhe titullin “Akademik”, pa qenë anëtar i asnjë akademie shkencore, “zbulon” se gjoja “në shekullin e dhjetë shqiptarët kanë ardhur nga Karpatet në Fushën e Matit mbi Tiranë. Prej aty janë shpërndarë në të gjitha anët e Shqipërisë së sotme, e cila në atë kohë ishte e banuar kryesisht nga serbët. Pas pushtimit turk, këta shqiptarë kaluan edhe kufijtë e Shqipërisë së sotme dhe u futën në Serbi, Maqedoni dhe Mal të Zi!” Në vijim të shpalosjes së “rezultateve shkencore”, ai përsërit sajaset serbe kinse: “deri në shekullin XVI kufijtë e Serbisë kishin qenë deri te brigjet e lumit Drin, që sot është në Shqipëri, ndërsa përpara kësaj kohe Serbia ka qenë e shtrirë deri në Durrës, të cilin stërgjyshërit e serbëve ua kishin marrë bizantinëve në vitin 548, në atë kohë kur në Shqipëri dhe në Ballkan nuk ka pasur asnjë shpirt të gjallë shqiptar. Shqiptarët në atë kohë ishin në Rumani në malet Karpate dhe Beskidi!”

**“Epoka e re”:** Përveç shkrimeve të kësaj natyre, Kapllan Burović ishte tejet aktiv edhe në mediet serbe, malazeze, madje dhe ruse! A i merr kush seriozisht këta njerëz që ndërrojnë sistematikisht jo vetëm pikëpamjet politike, por edhe origjinën etnike?

**Bardhyl Mahmuti:** Në rrafshin e propagandës që synon përpunimin e opinionit të brendshëm në Serbi, mohimi i historisë dhe i kulturës shqipe ka për synim ta mbajë gjallë shpresën për kthimin e Kosovës nën Serbi. Këtë e synim e bën të qartë edhe vetë titulli i

publicitetit që u jepet pikëpamjeve të “tij” (“Kosmet će se vratiti pod okrilje Srbije” - Kosova dhe Dukagjini do të kthehen në shtetullën e Serbisë). Ndërsa në rrafshin e skenës politike ndërkombëtare, në vitin 2007, serbët përkthyer në gjuhën angleze “zbulimet” e Kapllan Burović-it dhe i shpërndanë falas në qarqe të ndryshme intelektuale.

Që manipulimi të jetë më i madh, në faqen e parë të librit që mban titullin “Kapllan Burovic - Who are Albanians? (“Kush janë shqiptarët?”), pretendohet se gjoja Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka deklaruar se gjoja “çdo fjalë e akademik Burović-it lidhur me origjinën e shqiptarëve është e ditur që moti nga ne, përpara se ai ta merrte vesh këtë gjë. Por nuk është koha për ta pohuar një gjë të tillë tani. Më parë duhet ta bashkojmë Kosovën me Shqipërinë, e pastaj do ta pranojmë edhe ne vetë”!!!

Në përputhje të plotë me vijën propagandistike serbe, në një intervistë për “Sputnjikun” rus, Kapllan Burović deklaroi: “shqiptarët nuk janë ilirë, ata nuk janë autoktonë, por të ardhur në Ballkan.. As Gjergj Kastrioti-Skënderbeu e as Naim Frashëri nuk janë shqiptarë. Skënderbeu është serb, ndërsa Naim Frashëri, vllah”!

**“Epoka e re”:** Propagandë e tmerrshme!

**Bardhyl Mahmuti:** Pikërisht për këtë arsye, kryepeshkopi i Cetinjës dhe Mitropolit i Malit të Zi, Amfilohije Radović, e dekoroi me portretin e artë të Shën Pjetrit Kapllan Burović-in “Për besnikëri dhe vetëmohim për të vërtetën dhe drejtësinë e Perëndisë” që kishte dëshmuar në shkrimet dhe intervistat e tij.

**“Epoka e re”:** Fatkeqësisht, Kapllan Burović nuk është i vetmi “intelektual” që është futur në shërbim të përhapjes së të pavërtetave lidhur me historinë dhe kulturën tonë.

**Bardhyl Mahmuti:** I të njëjtit kallëp është edhe personi që për opinionin publik paraqitet me tri forma të mbiemrit të vet: “dr. Olsi Jazexhi/Olsi Yazeji/ Олси Јазехи”. Pas deklaratave të tij se “parajsa jugosllave është shkatërruar për shkak të komplotit të perëndimorëve, që janë kundër myslimanëve dhe kundër serbëve” dhe se “shteti i Kosovës është koloni e NATO-s, ku myslimanët dhe serbët janë të diskriminuar”, “dr. Olsi” me tre mbiemra u ftua në emisionin më antishqiptar në Maqedoni: “Vo Center” (Në qendër).

Gjatë kësaj interviste, “dr. Olsi” përsëriti sajaset e propagandës serbe se gjoja “para ardhjes së turqve në Ballkan, shumica e popullatës në Kosovë dhe në Maqedoni ka qenë serbe ortodokse. Gjithashtu, edhe në Shqipëri, ku edhe sot mund të gjeni shumë toponime sllave. Por, me ardhjen e turqve dhe islamit në Ballkan, kemi proces të islamizimit dhe shqiptarizimit. Skënderbeu nuk ka asnjë lidhje gjenetike dhe religjioze me shqiptarët, ai është i sajuar. Skënderbeun e kanë sajuar austriakët dhe i kanë mësuar shqiptarët që ta pranojnë. Edhe sot ata mendojnë se Skënderbeu është hero i tyre, por ai nuk është i shqiptarëve. Në kohën kur Skënderbeu ka luftuar kundër osmanlinjve, shqiptarët nuk kanë ekzistuar. Skënderbeu ka qenë luftëtar serbo-bullgar”.

Shkenca dhe “dr. Olsi Jazexhi/Olsi Yazeji/ Олси Јазехи” janë dy nocione që përjashtojnë njëri-tjetrin! Nuk

do të më habiste aspak që ky “Doktor shkence” të shpallet si “Akademik”, në të njëjtën mënyrë si dr. Kapllan Kallushi, Kapllan Resuli, Kapllan Resulbegoviqi, Kapllan Burović. Madje, për shërbimet e mëdha që u bën serbëve dhe maqedonaseve, nuk do të duhet të habitet askush nëse, në një të ardhme të afërt, “dr. Olsi” të dekorohet nga Kisha Ortodokse serbe me ndonjë dekoratë “me portretin e artë të Sveti Savës”! Mbetet të shihet nëse “dr. Olsi” do t’i shtojë edhe ndonjë mbiemër tjetër emrit të vet dhe të deklarojë, sikurse “dr. Kapllani”, se “nga hulumtimet e mëdha shkencore që ka bërë, ka zbuluar se ka origjinë serbe”!

Si përfundim, ata historianë dhe ata teologë me origjinë shqiptare që propagandojnë se gjoja “Skënderbeu nuk është Hero Kombëtar shqiptar”, se gjoja “humanistja shqiptare me përmasa botërore, Nënë Tereza, është grua e pamoralshme, që ndërron burrat kur të dëshirojë dhe se vendin e ka në xhehenem”, se gjoja “në vitin 1445 vetëm 1 % e qytetarëve në Kosovë ishin shqiptarë, ndërsa turqit sollën shqiptarët në Kosovë dhe u dhanë toka atyre”, ata nuk sjellin asgjë të re në “tregun” shqiptar, pos produkteve serbe dhe maqedonase, të ambalazuara pa datë dhe vend prodhimi. Po e përsëris: çdo historian, çdo teolog dhe çdo person tjetër që përhap këto sajaset, i bën një shërbim të madh strategjisë antishqiptare serbe dhe maqedonase!

**“Epoka e re”:** Nëse nuk kemi njësi matëse për t’i ditur efektet e kësaj propagande në skenën politike ndërkombëtare, a mund të kemi ndonjë konstatim të

përafërt rreth ndikimeve që kanë mundur të kenë në opinionin publik shqiptar?

**Bardhyl Mahmuti:** Ofensiva e gjithanshme për të mohuar çdo gjë shqiptare dhe për t’i paraqitur shqiptarët si krijesë e Perandorisë Osmane që paraqet rrezik për Evropën, u bë në funksion të alarmimit të opinionit të vendeve perëndimore se gjoja “shteti i pavarur i Kosovës do të ishte tempull i krimit të organizuar në zemër të Evropës që do të shndërrohej në një bazë për islamizimin e kontinentit”!!! Imazhet e nxënësve shqiptarë që falen mbi bankat shkollore apo në trotuare dhe në rrugë shoqërohen me të dhëna ku janë pjesëtarë të përkatësisë etnike shqiptare janë të përfshirë në akte terroriste me konotacion fetar.

Shembulli i Arid Ukës, 21 vjeç nga Kosova, i cili kreu një sulm terrorist kundër ushtarëve amerikanë në Aeroportin e Frankfurtit, në Gjermani, me ç’rast u vranë dy ushtarakë amerikanë dhe u plagosën dy të tjerë, pushtoi mediet e shteteve demokratike e veçanërisht ato amerikane. Mashtrohen të gjithë ata që mendojnë se nuk kanë pasur ndikimin e tyre negativ aktet e tilla apo të atyre që iu bashkuan të ashtuquajturit Shtet Islamik!

Të gjitha veprimet e tilla kanë dëmtuar imazhin e shqiptarit dhe çuar ujë në mullirin e armiqve që vazhdimisht bluajnë millin për sajaset antishqiptare.

**(Muhamet MAVRAJ / Të dashur lexues! Periudha nga shpallja e pavarësisë së Kosovës e deri te krijimi i së ashtuquajturës Gjykatë Speciale do të përfshihet në variantin e botimit si libër!)**





## Kosova dhe Turqia nënshkruajnë marrëveshje ushtarake

PRISHTINË, 29 JANAR - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, së bashku me delegacionin e tij nga Ministria e Mbrojtjes dhe e FSK-së, po qëndrojnë në vizitë zyrtare në Republikën e Turqisë, me ftesë nga ministri i Mbrojtjes Kombëtare i Turqisë, Yasar Guler. Takimi i dy ministrave të mbrojtjes filloi me pritje ceremoniale ushtarake. Takimi u përmyll me

nënshkrimin e Marrëveshjes Ushtarake Kornizë, me anë të së cilës pritet thellimi i bashkëpunimit ushtarak në shumë drejtime. Shkëmbimi i personelit ushtarak, shkollimet, trajnimet e përbashkëta, investimi në industrinë e mbrojtjes si dhe trajtimi shëndetësor i pjesëtarëve të FSK-së në Turqi, ishin disa nga çështjet të cilat ministrat

diskutuan, e që përmes marrëveshjes së nënshkruar i hapet rrugë procesit për realizimin e tyre. "Krahas lidhjes kulturore ndërmjet dy shteteve tona, tashmë ekziston një bashkëpunim i ngushtë në aspektin ushtarak, me qëllim që së bashku t'i kontribuojmë ruajtjes së paqes dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë", ka theksuar ministri Maqedonci.



## SBASHK-u vazhdon përgatitjet për Konferencën për shëndetin mendor në shkolla

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 29 janar - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) ka njoftuar se është duke vazhduar përgatitjet për Konferencën për shëndetin mendor në shkolla.

SBASHK-u ka bërë me dije se me mbështetje të Qendrës Amerikane të Solidaritetit më 20 dhe 21 shkurt do ta organizojnë Konferencën për shëndetin mendor në shkolla. "Shtimi i rrezikut nga prania e dukurive negative në shkolla dhe përplasjet e kacafytjet, që po përfundojnë me lëndime të rënda e madje edhe me vdekjen e të rinjve e shtojnë arsyen për një aktivitet të tillë. Pjesëmarrësit e kësaj tryeze kanë caktuar datat 20 dhe 21 shkurt për mbajtjen e Konferencës 'Kujdesi për shëndetin mendor në shkolla'. SBASHK-u bashkë me Qendrën



Amerikane të Solidaritetit janë duke vazhduar me angazhimet

me qëllim që në këtë ngjarje të veçantë të jenë pjesëmarrës

specialistë të kësaj fushe dhe të nxjerrën detyra konkrete të

angazhimeve për secilën palë që është e ndërlidhur me arsimin", është theksuar në njoftimin e SBASHK-ut.

Në kuadër të angazhimeve për përgatitjen e kësaj Konference përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë zhvilluar konsulta të vazhdueshme me përfaqësues të Qendrës Amerikane të Solidaritetit, por edhe me Odën e Mjekëve dhe të Infermierëve, me qëllim që ata të kontribuojnë me profesionalistë të fushës për rrjedhën e mbarë të kësaj konference. "Në këtë konferencë do të marrë pjesë edhe drejtoresha ekzekutive e Qendrës Amerikane të Solidaritetit me seli në Uashington, Shauna Bader Blau, përfaqësues të sindikatave simotra nga Sllovenia dhe vende të Ballkanit dhe profesionalistë të shumtë të fushës që ndërlidhet me temën e kësaj ngjarje të veçantë për arsimin në Kosovë", ka njoftuar SBASHK-u.

## Kastrati i PDK-së: Synojmë të dalim partia e parë në zgjedhjet e ardhshme



Prishtinë, 29 janar - Deputeti PDK-së, Ardian Kastrati, në një intervistë për gazetën "Blic", ka deklaruar se nuk kanë kërkuar zgjedhje këtë vit. Kastrati ka kritikuar qeverinë Kurti për keqeverisje, teksa shton se po katandiset Kosova. "Zgjedhjet të parakohshme nuk kemi kërkuar këtë vit, por kemi kërkuar një konsistencë gjatë këtij mandati.

Qeveria ka vërtetuar se me keqeverisjen e saj, me paaftësinë e saj për t'i menaxhuar edhe projektet më të vogla, po e katandis Kosovën në një mjerim total, kështu që në zgjedhje duhet të shkohet sepse nga kjo qeveri vendi po kthehet si i pajetës", ka thënë ai. Duke folur për mundësinë që vendi të shkojë në zgjedhje,

Kastrati shton se PDK-ja si çdo parti tjetër synon të dalë e para teksa nuk përjashton edhe një koalicion të përbashkët me ndonjë parti opozitare. "Natyrshisht që PDK-ja si çdo parti tjetër synon të dalë e para dhe ta formojë koalicionin me ndonjë parti tjetër për qeverisje të ardhshme", ka deklaruar Kastrati.

## KQZ-ja nis verifikimin e nënshkrimeve për shkarkimin e kryetarëve në veri

PRISHTINË, 29 JANAR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka filluar procesin e verifikimit të nënshkrimeve të mbledhura në peticionin e organizuar nga serbët për shkarkimin e kryetarëve në katër komunat në veri. Lajmin e ka bërë me dije për "Epokën e re" zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi. Ai ka thënë se ky proces do të marrë kohë për shkak se të dhënat janë në format fizik.

"Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka filluar procesin e verifikimit të nënshkrimeve të mbledhura në peticionin e organizuar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok. KQZ, në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të verifikojë këto lista me nënshkrime, pra nëse personat që kanë nënshkruar janë qytetarë me të drejtë vote në komunën përkatëse.

Sigurisht se ky proces do të na marrë kohë pasi të dhënat që i kemi pranuar janë të mbledhura në format fizik, andaj nuk mund të jap ndonjë datë të saktë por, pas përfundimit të tij, do ta njoftojmë ministrinë, kryesuesit e kuvendeve komunale, kryetarët e komunave dhe grupet nismëtare. Natyrshisht se përgjigjja e KQZ-së do të bëhet edhe publike", ka thënë Elezi.



## Murati: Ligji për TVSh-në është në procesin e përditësimit

PRISHTINË, 29 JANAR - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se Ligji për TVSh-në është në procesin e përditësimit dhe se grupet punuese janë duke punuar që deri në fund të këtij viti të jetë ligji i ri, i cili do t'i marrë parasysh kërkesat, nevojat e përshtatjen me trendët. Ai këto deklarime i bëri në konferencën për medie të mbajtur të hënën nga

Dogana e Kosovës, në të cilën u paraqitën "lehtësirat e krijuara", ku tha se janë të përkushtuar t'i ndihmojnë bizneset për të bërit tregti. "Për t'i mbështetur prodhuesit vendorë në tetorin e vitit të kaluar kemi miratuar lirim nga taksa doganore për disa prej lëndëve, gjithashtu edhe për pjesët rezervë të makinerive prodhuese ashtu që ta kenë

më të lehtë të shtojnë vlerë në vendin tonë. Edhe Ligji për TVSh-në është në procesin e përditësimit. Tashmë kemi grupet punuese dhe jemi duke punuar që deri në fund të këtij viti ta kemi një ligj të ri, i cili do t'i marrë parasysh kërkesat, nevojat, përshtatjen me trendët, por edhe mbështetjen për bizneset dhe prodhuesit vendorë", ka thënë Murati.



## Hovenieri i kërkon guvernatorit të BQK-së ta shtyjë zbatimin e vendimit për dinar

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 29 JANAR - Ambasadori amerikan, Jeff Hovenier, i ka kërkuar guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës, Ahmet Ismaili, ta shtyjë zbatimin e vendimit për përdorimin vetëm të valutës euro sa iu përket operacioneve me para të gatshme.

Kërkesë të njëjtë ShBA-ja ka bërë edhe ditë më parë.

Rregullorja e miratuar nga BQK-ja, që nga serbët në Kosovë është parë si vendim që do t'u pamundësojë atyre ta përdorin dinarin, është paraparë të hyjë në fuqi më 1 shkurt. "Sot zhvillova një takim produktiv me guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës, Ahmet Ismaili. Përsërita shqetësimet e ShBA-së lidhur me zbatimin e rregullores së miratuar për operacionet me para të gatshme. Ne bëjmë thirrje që zbatimi i kësaj rregulloreje të shtyhet në mënyrë që të japë kohë për tranzicion më efektiv dhe komunikim me publikun që të zbutet ndikimi negativ te qytetarët", ka shkruar Hovenier në platformën "X".

Takimi në mes të ambasadorit Hovenier dhe guvernatorit Ismaili erdhi një ditë pasi shtetet e



Quintit - ShBA-ja, Britania, Gjermani, Italia dhe Franca - bënë kërkesën e njëjtë për shtyrjen e zbatimit të vendimit për rregulloren për operacione me para të gatshme.

Nga Qeveria e Kosovës kanë argumentuar se vendimi i BQK-së është në përputhje me

Kushtetutën e Kosovës, por Quinti ka thënë se ky vendim "ngre shqetësime në lidhje me ndikimin në veçanti në komunitetet me shumicë serbe". Ndërkaq, Bashkimi Evropian ka thënë më herët se ka kërkuar sqarime nga Kosova për këtë vendim, i cili, sipas Listës Serbe,

partisë kryesore të serbëve në Kosovë, që gëzon mbështetjen e Serbisë, rrezikon mbijetesën e serbëve në Kosovë.

Në Kosovë, në të gjitha vendbanimet me shumicë serbe, popullsia përdor dinarin serb për të kryer pagesa dhe ata që punojnë në institucionet serbe në

Kosovë, i marrin edhe pagat me dinarë.

Me dinarë paguhen edhe pensionet, sipas sistemit serb, si dhe shtesat për fëmijë dhe ndihmat sociale. Në objektet tregtare, në zonat ku banojnë serbët në Kosovë, përveç euros, përdoret edhe dinari.

## KEDS-i zvogëlon humbjet në rrjet në 15,32 %



PRISHTINË, 29 JANAR - Në fund të dhjetorit të vitit të kaluar KEDS-i ka zvogëluar humbjet në rrjetin elektroenergetik të Kosovës në 15,32 %. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, kur humbjet ishin 16,79 %, është shënuar rënie prej 1,5 %. Ky zvogëlim i humbjeve është rezultat i përkushtimit të pakompromis të KEDS-it në luftimin e fenomenit të shëmtuar të keqpërdorimit të energjisë elektrike.

KEDS-i ka njoftuar se ka shtuar ekipet e kontrollit në terren me qëllim të identifikimit të të gjithë keqpërdoruesve të energjisë

elektrike, duke implementuar strategji të reja në zvogëlimin e më shumë të humbjeve në rrjet.

Krahas kësaj, KEDS-i ka ndërmarrë një fushatë të gjerë informimi të opinionit publik lidhur me pasojat që mund t'i ketë kushdo që mëton ta keqpërdorë energjinë elektrike.

Përmes hapave të ndërmarrë në fushatën "Rryma t'kushton ma lirë", KEDS-i po angazhohet të ndihmojë në kultivimin e një kulture të përgjegjshme ndaj përdorimit të energjisë elektrike. "Se përdorimi i ligjshëm i energjisë elektrike kushton gjithsesi më lirë

sesa dëmi që një konsumator ia shkakton KEDS-it e që duhet t'i kthehet përmes 'Rikthimit të humbjeve' ose edhe dënimet me gjobë dhe me burg nga gjykatat kompetente. KEDS-i ka realizuar gati 100 000 kontrolle përgjatë vitit 2023, prej të cilëve 6 710 janë identifikuar keqpërdorues të energjisë elektrike. Rikujtojmë se keqpërdorimi i energjisë elektrike hyn në kuadër të 'Vjedhjes së shërbimeve', gjë që, sipas nenit 314 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, është e dënueshme me gjobë dhe deri në tri vjet burg", ka njoftuar KEDS-i.

## Protestojnë punëtorët e KOSTT-it, shprehen të pakënaqur me pagat

PRISHTINË, 29 JANAR - Sindikatat dhe punëtorët e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të

Kosovës (KOSTT) kanë protestuar të hënën para objektit të kësaj ndërmarrje. Ata kanë shprehur

pakënaqësinë me "rritjen e përshkallëzuar" prej 15-përqindësh deri në 3 për qind të pagave. Sipas tyre, rritja e

përshkallëzuar e pagave thëllon hendekun në mes të punëtorëve dhe stafit menaxherial të KOSTT-it.





# Alarmi i gjeneralëve të NATO-s: Putin mund të godasë në të gjithë Evropën, kemi 3 vite për t'u përgatitur për luftë



Gjeneralët e lartë të NATO-s kanë paralajmëruar se Vladimir Putin mund të godasë objektiva në të gjithë Evropën në një luftë gjithëpërfshirëse kundër Perëndimit.

Udhëheqësit i thanë Times se blloku mund të ketë jo më pak se tre vjet për t'u përgatitur për një ofensivë të mundshme ruse në tokën evropiane, e cila do të shihte sulme kundër infrastrukturës civile dhe ushtarake thellë pas vijave të frontit.

Ata thanë se Gjermania ka të ngjarë të veçohet si "fortesa" qendrore për linjat e furnizimit kontinental të NATO-s dhe se objektivat mund të variojnë nga fabrikat e municioneve dhe qendrat komanduese, te termocentralet, hekurudhat dhe urat.

Rusia ka përdorur tashmë taktika të ngjashme gjatë pushtimit të saj në Ukrainë, duke lëshuar raketa thellë brenda territorit ukrainas, ndërsa vetë Ukraina është kundërpërgjigjur duke synuar depot e municioneve, karburantit dhe qendrat e komandës.

Gjeneral-lejtnant Alexander Sollfrank, komandanti i qendrës logjistike ushtarake të NATO-s në Gjermaninë jugperëndimore,

tha: "Nëse krahasojmë luftën dhe operacionet dhjetë vjet më parë ose pesë vjet më parë, atëherë kuptojmë se duhet të pranojmë se edhe zonat e pasme do të goditen ashpër".

"Duhet të supozojmë se një agresor do të përdorë të gjithë spektrin e forcës kinetike dhe jokinetike për të shkatërruar linjat e komunikimit, edhe në pjesën e brendshme të territorit. Kjo varion nga aktet e sabotimit përmes luftës elektronike dhe kibernetike deri te mundësitë kinetike përmes raketave, dronëve e kështu me radhë", shtoi ai.

Gjenerali i NATO-s u bëri thirrje liderëve botërorë që të shkurtojnë "burokracinë" që pengon aftësinë e vendeve për të përdorur armë dhe teknologji nga një komb tjetër.

Sollfrank tha se rregullat mbi përdorimin e armatimeve dhe pajisjeve të ndryshme, ngadalësoi masivisht kohën e përgjigjes dhe kjo u pa në ofensivën ukrainase përballë fuqisë së Kremlinit.

Ai dha një shembull të parashutistëve që u ndalohe ligjërisht përdorimi i parashutave të bëra për ushtrinë e një kombi tjetër, edhe nëse ato janë funksionalisht identike.

"Edhe pse mund të mos lejohet për momentin, teknikisht nuk ka asnjë problem në shumë raste. Ku është problemi, për shembull, me një parashutist nga një komb evropian A duke përdorur një parashutë të një kombi fqinj B pasi është trajnuar në këtë sistem, ose duke bashkuar pajisje nga një komb në helikopterin e një kombi tjetër? Nëse nuk ka çështje teknike apo sigurie, pse jo", shtoi pyetjen Sollfrank.

Ai tha se reduktimi i burokracisë për organizatat shumëkombëshe do të ishte çelësi për të siguruar që NATO të jetë e shkathët për të luftuar Rusinë.

Gjeneralët e lartë të NATO-s kanë paralajmëruar se Vladimir Putin mund të godasë objektiva në të gjithë Evropën në një luftë gjithëpërfshirëse kundër Perëndimit.

Udhëheqësit i thanë Times se blloku mund të ketë jo më pak se tre vjet për t'u përgatitur për një ofensivë të mundshme ruse në tokën evropiane, e cila do të shihte sulme kundër infrastrukturës civile dhe ushtarake thellë pas vijave të frontit.

Ata thanë se Gjermania ka të ngjarë të veçohet si "fortesa" qendrore për linjat e furnizimit kontinental të NATO-s dhe se

objektivat mund të variojnë nga fabrikat e municioneve dhe qendrat komanduese, te termocentralet, hekurudhat dhe urat.

Rusia ka përdorur tashmë taktika të ngjashme gjatë pushtimit të saj në Ukrainë, duke lëshuar raketa thellë brenda territorit ukrainas, ndërsa vetë Ukraina është kundërpërgjigjur duke synuar depot e municioneve, karburantit dhe qendrat e komandës.

Gjeneral-lejtnant Alexander Sollfrank, komandanti i qendrës logjistike ushtarake të NATO-s në Gjermaninë jugperëndimore, tha: "Nëse krahasojmë luftën dhe operacionet dhjetë vjet më parë ose pesë vjet më parë, atëherë kuptojmë se duhet të pranojmë se edhe zonat e pasme do të goditen ashpër".

"Duhet të supozojmë se një agresor do të përdorë të gjithë spektrin e forcës kinetike dhe jokinetike për të shkatërruar linjat e komunikimit, edhe në pjesën e brendshme të territorit. Kjo varion nga aktet e sabotimit përmes luftës elektronike dhe kibernetike deri te mundësitë kinetike përmes raketave, dronëve e kështu me radhë", shtoi ai.

Gjenerali i NATO-s u bëri thirrje


liderëve botërorë që të shkurtojnë "burokracinë" që pengon aftësinë e vendeve për të përdorur armë dhe teknologji nga një komb tjetër.

Sollfrank tha se rregullat mbi përdorimin e armatimeve dhe pajisjeve të ndryshme, ngadalësoi masivisht kohën e përgjigjes dhe kjo u pa në ofensivën ukrainase përballë fuqisë së Kremlinit.

Ai dha një shembull të parashutistëve që u ndalohe ligjërisht përdorimi i parashutave të bëra për ushtrinë e një kombi tjetër, edhe nëse ato janë funksionalisht identike.

"Edhe pse mund të mos lejohet për momentin, teknikisht nuk ka asnjë problem në shumë raste. Ku është problemi, për shembull, me një parashutist nga një komb evropian A duke përdorur një parashutë të një kombi fqinj B pasi është trajnuar në këtë sistem, ose duke bashkuar pajisje nga një komb në helikopterin e një kombi tjetër? Nëse nuk ka çështje teknike apo sigurie, pse jo", shtoi pyetjen Sollfrank.

Ai tha se reduktimi i burokracisë për organizatat shumëkombëshe do të ishte çelësi për të siguruar që NATO të jetë e shkathët për të luftuar Rusinë.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

# Shumë yjet pritet të largohen nga Superliga



**PRISHTINË, 29 JANAR** - Kanë mbetur më pak se 72 orë deri në fundin e afatit kalimtar të janarit. Orët e fundit janë duke u pritur me kureshtje të madhe edhe nga tifozët e klubeve të Kosovës. Si kurrë më parë, shumë emra nga kampionati i Kosovës janë duke u përfolur për një transferim të mundshëm në klube të ndryshme evropiane. Ballkani, Drita, Prishtina dhe Malisheva mund të mbesin pa lojtarët e tyre kryesorë në ditët e fundit të afatit kalimtar dimëror.

Kampioni në fuqi i Kosovës ka shitur Qëndrim Zybën te giganti polak Legia Varshavës për shumën e 500 mijë eurove, por ky nuk është largimi i fundit që do t'u ndodhë suharekasve. Në fakt ata kanë oferta për shumë yje të skuadrës, si Lumbardh Dellova, Edvin Kuç, Nazmi Gripshi, Almir Kryeziu dhe Albin Berisha. Qëndërmbrojtësi dardan Lumbardh Dellova ka ofertë zyrtare nga New York City në SHBA, por edhe nga Viktoria Plzen, Ludogorets e Astana. Deri më tani Ballkani u ka rezistuar të gjitha ofertave, derisa mbetet të shihet deri më 31 janar nëse do të mbetet rahoveciani në Suharekë apo do të largohet për ta bërë hapin e madh në karrierë. Një tjetër futbollist që mund t'u largohet kampionëve në fuqi është sulmuesi Albin Berisha që ka ofertë

nga Rumania me skuadrën Petrolul që po kërkon shërbimet e tij. Nga klubi mund të largohet edhe kapiteni Edvin Kuc, i cili kërkohet në Azerbajxhan nga skuadra Baku, por edhe në Kazakistan ku Astana, Aktobe e Kairat Almaty. Interesime të shumta ka pasur edhe për Nazmi Gripshin nga klube të ndryshme, por edhe për Almir Kryeziun. Largime të rëndësishme pritet të ketë Drita e Gjilanit, një tjetër skuadër që po kërkon titullin e kampiones në Kosovë. Gjilanasit kanë një marrëveshje në parim me skuadrën ukrainase LNZ Cherkasy për shitjen e dy yjeve të skuadrës. Mesfushori Muharrem Jashari dhe qendërmbrojtësi Hajdin Salihu do të largohen nga Drita për t'iu bashkuar kësaj skuadre për shumën e 400 mijë eurove, derisa gjilanasit do të mbajnë edhe një përqindje të kartonit nga shitjet e ardhshme. Drejtuesit e dy skuadrave kanë gjetur një marrëveshje gjatë kohës sa po qëndronin dy skuadrat në Turqi për fazën përgatitore dhe zyrtarizimi është çështje orësh, raporton "Telegrafi". Drilon Hazrollaj dhe Jalen Blesa janë dy lojtarët e tjerë që kanë lënë gjurmë në pjesën e parë të sezonit në elitën e futbollit të Kosovës. Malisheva dhe Prishtina mund t'i humbasin

xhevahirët e tyre në ditën e fundit të afatit kalimtar të janarit. Hazrollaj konsiderohet një nga talentet më të mëdhenj në vendin tonë dhe ai ka pasur një vit të jashtëzakonshëm në elitën e futbollit të Kosovës me gola e asistime. Shumë skuadra kanë shprehur interesim për transferimin e tij nga Evropa, megjithatë Malisheva deri më tani u ka rezistuar të gjitha ofertave. Gjithsesi deri në fund të 'merkatos' kanë mbetur edhe disa orë dhe e ardhmja e Hazrollajt vazhdon të jetë e paqartë së paku deri më 31 janar. Në të njëjtën situatë si Malisheva është edhe Prishtina që mund ta humbasë tophënuesin Jalen Blesa. Sulmuesi spanjoll ka shumë kërkesa nga klube polake, rumune, moldave e sllovene. Dinamo Bukuresht, Sheriff Tiraspol, Mura dhe Cracovia kanë shprehur interesim për shërbimet e tij, derisa 72 orët e ardhshme pritet të jenë vendimtare për të parë nëse Blesa do të largohet nga Prishtina apo do të mbetet në kryeqytetin e Kosovës. Kur kanë mbetur më pak se 72 orë deri në fund të afatit kalimtar të janarit, Superliga e Kosovës mund të mbetet më e varfër sa i përket cilësisë pasi shumë yje mund të largohen, por klubet e Kosovës do të jenë më të pasura nga shitja eventuale e tyre.

## SHKURT

### Donjeta Sadiku përgatitet në Sofje për Olimpiadën e Parisit

Bokserja Donjeta Sadiku është duke u përgatitur në kampin ndërkombëtar në Sofje të Bullgarisë para turneut ndërkombëtar "Stradnja", që mbahet prej 4-12 shkurtit në kryeqytetin bullgar. Shpenzimet e Sadikut po i mbulon Komuniteti Olimpik i Kosovës. Përgatitjet dhe pjesëmarrja në turne i duhen para turneut kualifikues botëror për Lojërat Olimpike "Paris 2024" që mbahen prej 4-11 mars 2024 në Busto Arsizio të Italisë.

### Sadiku rikthehet te Kasimpasa

Futbollisti i njohur shqiptar Loret Sadiku është rikthyer në futbollin turk. Në fakt, Kasimpasa Spor Kulubu e ka zyrtarizuar transferimin e Sadikut, i cili për këtë klub në periudhën 2016-2021, kishte përfunduar te Hammarby. 32-vjeçari ka nënshkruar kontratë me klubin turk deri në vitin 2026. Sadiku ka luajtur edhe për këto skuadra IFK Varnamo, Helsingborgs IF dhe Mersin Idman Yurdu.

### KB Trepça konfirmon largimin e Gallowayt

KB Trepça ka njoftuar se i ka ndarë rrugët me basketbollistin amerikan Brevin Galloway. Mitrovicasit e kanë falënderuar lojtarin e tyre të deritashëm, me të cilin kishin bashkëpunuar nga fillimi i këtij sezoni. "Faleminderit Brevin. Gjithmonë do të jesh një prej nesh", kanë shkruar mitrovicasit në faqen e tyre zyrtare në "Facebook". Edhe lojtari e ka falënderuar klubin për mundësinë e dhënë për të luajtur me "Xehetarët".

### Xhaka sërish në formacionin e javës në Bundesliga

Mesfushori shqiptar Granit Xhaka ka vazhduar me paraqitje të shkëlqyera në elitën e futbollit gjerman Bundesliga me fanellën e Bayer Leverkusenit. Kapiteni i Kombëtares së Zvicrës ka qenë ndër më të mirët në kuadër të xhiros së 19, ku Bayer Leverkuseni barazoi pa gola 0-0 me Borussia Moenchengladbachun. Xhaka është përfshirë në formacionin e javës në elitën e futbollit gjerman nga faqja e specializuar për vlerësimin e futbollistëve, "SofaScore". Formacioni: Nicolas, Trimmel, Stanisiq, Elvedi, Gosens, Xhaka, Wirtz, Undav, Fuhrich, Demiroviq, Fullkrug.

## Pesëshja e javës në Superligën e Femrave

Superliga Femrat po vazhdon të dhurojë superndeshje në çdo xhiro. Në kuadër të javës së 16 janë zhvilluar tri ndeshja mjaft interesante. Kryendeshja u zhvillua në kryeqytet në mes të Prishtinës dhe Peja 03, e ku Prishtina vazhdoi serinë pozitive duke shënuar kështu fitoren e radhës me rezultat 75:62. Dyshja

amerikane Williams dhe Johnson edhe një herë tjetër patën paraqitje të shkëlqyeshme. Jade Williams me 28 pikë, 15 kërcime dhe 1 asistime, kurse Asiane Johnson me 22 pikë, 7 kërcime dhe 5 asistime. Fitore shënoi edhe Bashkimi ndaj Trepçës me rezultat 75:88. Adrienne Godbold debutoi në

Superliga Femrat me 22 pikë, kurse u ndihmua nga bashkëlojtarja Arbnore Përquku e cila shtoi edhe 19 pikë të tjera. Edhe Penza shënoi fitore të thellë ndaj United Basketball me rezultat 68:37. Më e dalluara te vashat pejane ishte Saranda Daci me 17 pikë, 12 kërcime dhe 2 asistime.

3	25	7	0	9
Anesa	Jade	Sarah	Asiane	Aulona
Koraga	Williams	Mgbeke	Johnson	Muhadri

## Sinner për triumfin në Australian Open: Nuk mund ta besoj ende

MELBOURNE, 29 JANAR - Triumfi i Jannik Sinner në "Australian Open" bëri jehonë në mbarë botën. Ishte i pari italian që fitoi një grand slam, teksa mundi 3-2 me përmbysje rusin Medvedev. Tenisti "axurr" tregoi provë karakteri, nuk u dorëzua edhe

pse humbi dy setet e para. Ky triumf bëhet edhe më madhështor, pasi Sinner ishte i pari që eliminoi Novak Djokoviçin, rekordmenin e "Australian Open", numrin një në botë. "Nuk kam fjetur shumë, por është një ndjenjë e

mrekullueshme të kuptoj ngadalë atë që kam bërë. Është një rezultat fantastik për mua dhe për ekipin tim. Jam shumë i lumtur. Natyrisht që kishte shumë emocione në kokën time menjëherë pas pikës së ndeshjes: puna e vështirë dhe

sakrificat më erdhën në mendje. Nuk mund ta besoj akoma, tani po e filloj ta kuptoj ngadalë. Është një ndjenjë e mrekullueshme. Do ta shijoj këtë moment, pastaj do të shoh nga e ardhmja", u shpreh Sinner, tashmë numri katër në botë.



## Asllani: Inzaghi më la të qetë, Calhanoglu dhe Martinezë më ndihmojnë shumë

MILANO, 29 JANAR - Lautaro Martinez shënoi golin me vlerën e tri pikëve, por heroi i vërtetë i Interit në transfertën ndaj Fiorentinës ishte padyshim mesfushori i Kombëtares Shqiptare, Kristjan Asllani, pasi të gjithë prisnin me interes për të parë si do t'ia dilte të zëvendësonte një futbollist si turku Calhanoglu. Pas ndeshjes, Asllani mori sërish vëmendjen e medias teksa, ndër të tjera, zbuloi se është më i bindur se kurrë që ka marrë vendimin e duhur për të mos u larguar nga Interi gjatë merkatos.



Më në fund vjen momenti juaj...

**Asllani:** Tek Interi askush nuk kërkon më shumë hapësira. Të gjithë punojmë dhe është trajneri ai që merr vendimet. Unë kam përpara një mesfushor si Calhanoglu, që është fantastik dhe për më tepër, më qëndron pranë dhe më ndihmon shumë. Më ka këshilluar shumë edhe gjatë kësaj jave.

Me Lautaron duket se kuptoheni mirë dhe sot i dhatë një asistim...

**Asllani:** Ai është një kapiten i vërtetë, i pari që është gjithmonë gati të më ndihmojë. Më ka qëndruar pranë dhe më ka folur

vazhdimisht, edhe gjatë kohës së merkatos. Një kapiten dhe lider i vërtetë, ndaj e falënderoj për atë që bën. Goli ishte diçka e provuar shumë herë në stërvitje dhe më vjen mirë që funksionoi edhe në ndeshje dhe morëm tri pikët.

Çfarë të ka kërkuar Inzaghi në veçanti?

**Asllani:** Më ka lënë të qetë gjithë javën, për të mos pasur presion. Nuk ka treguar asnjë vëmendje speciale ndaj meje këtë javë dhe më ka dhënë mundësinë ta përgatisi i qetë këtë 90-minutësh e të bëj atë që di më mirë në fushë. Kemi komunikuar shumë me

shokët e skuadrës dhe kemi ndihmuar njëri-tjetrin për të marrë një fitore mjaft të rëndësishme.

Qëndruat tek Interi edhe pse kishit për para disa futbollistë shumë të fortë...

**Asllani:** Kam dy vjet që jam pjesë e Interit dhe jam shumë i bindur që kam bërë zgjedhjen e duhur. Kam futbollistë të shkëlqyer në ekip. Në rolin tim kam Calhanoglu që më ndihmon shumë. Me këta lojtarë mund të përmirësohesh çdo ditë e më shumë dhe të synosh nivele gjithnjë e më të larta.

## Oklahoma humbet, por mbron vendin e parë në Perëndim, triumfojnë Chicago dhe Indiana



ORLANDO, 29 JANAR - Oklahoma u mundi me rezultat 120-104 në fushën e Detroitit, por gjithsesi ruan vendin e parë në Konferencën e Perëndimit. Ndeshje e dominuar nga

vendasit, ku u dallua Duren me 22 pikë dhe 21 asistime, duke i bërë të pavlefshme 31 pikët e Shaht për miqtë. Jashtë fushës fiton Chicago, që mundi me shifrat 104-96 Portlandin,

ndeshje ku u dallua DeRozan me 20 pikë. Fitore në sekondat e fundit për ekipin e Atlantës, që falë 30 pikëve e 12 reboundeve të Trae Young, mundi me rezultat 126-125 Toronton. Fiton edhe skuadra e Indianas, që mundi me rezultat 116-110 Memphisin. Mathurin me 24 pikë, që e nisi ndeshjen nga stoli, ishte shënuesi më i mirë për miqtë. Ekipi i Orlandos, falë një loje të mirë kolektive (realizuan 11 lojtarë), mundi me rezultat 113-98 Phoenixin (Booker 44 pikë).

### REZULTATET

Detroit - Oklahoma	120-104
Indiana - Memphis	116-110
Orlando - Phoenix	113-98
Atlanta - Toronto	126-125
Portland - Chicago	96-104

## Dy klubet angleze në garë për Davies

Nuk është vetëm Reali i Madridit klubi që po e dëshiron Alphonso Davies. Interesim për lojtarin e

Bayern Munchen kanë treguar dhe dy klubet angleze Chelsea dhe Manchester City. Bayerni

dëshiron ta mbajë në radhët e veta futbollistin që ka kontratë deri në vitin 2025, kurse Reali

është i gatshëm të ofrojë 50 milionë. 20 milionë më shumë se klubi spanjoll është i gatshëm

të ofrojë City. Ndërsa për klubin e Chelseat ende nuk dihet se çfarë shumë do të ofrojë.

### SHKURT

#### Tri klube italiane e dëshirojnë Kumbullën

Futbollisti shqiptar Marash Kumbulla mund të jetë duke kaluar ditët e fundit në skuadrën e Romës. Mediet italiane kanë raportuar se mbrojtësi shqiptar mund të transferohet në një skuadër tjetër për të pasur më shumë minuta në dispozicion. Tri klubet italiane që e dëshirojnë Kumbullën janë Verona, Torino dhe Cagliari, por të tre këto skuadra e kërkojnë në formë huazimi pasi nuk janë të sigurt për kushtet e tij fizike, me Kumbullën që vjen pas një lëndimi të gjatë.

#### Leao: Nuk kam menduar të largohem nga Milani

Futbollisti Rafael Leao ka thënë se asnjëherë nuk ka menduar të largohet nga Milani, ani pse vazhdimisht flitet për një transferim të asit portugez në PSG. Leao gjithashtu ka thënë se Paolo Maldini i ka ndihmuar shumë dhe se është duke i munguar. "A kam menduar ndonjëherë të largohem? Jo, kam pasur vështirësitë e mia në fillim, kur mbërrita. Maldini më ka ndihmuar shumë, më ka telefonuar para se të arrija në Milano. Natyrisht, edhe më ka qortuar, po me personalitetin e fortë që rrezaton më ndihmoi të rritesha si burrë. A më mungon Paolo? Po, sigurisht", ka thënë Leao.

#### Xavi: Nuk qëndroj edhe nëse e fitoj Ligën e Kampionëve

Trajneri Xavi Hernandez është i vendosur për t'u larguar nga Barcelona në verë. Trajneri spanjoll ka insistuar se do të largohet nga "Camp Nou" edhe nëse Barcelona e fiton Ligën e Kampionëve. "Unë nuk do të rri këtu edhe nëse e fitoj Ligën e Kampionëve. Ne do të garojmë për Ligën e Kampionëve, po ashtu edhe në La Liga, edhe pse do të jetë mjaft e vështirë... por, ne do të jemi atje. Por, edhe nëse ne shkojmë në 'Wembley' dhe e fitojmë titullin e Ligës së Kampionëve, do ta lë pozitën e trajnerit në muajin qershor", ka thënë Xavi. "A është kjo zgjidhja e problemeve të Barçës? Po, është", ka shtuar Xavi.

#### De Gea, afër transferimit te Al Shabab

Ish-portieri i Manchester United, David De Gea është afër transferimit në ligën e Arabisë Saudite. Bisedimet mund të mbyllën gjatë kësaj jave dhe 33-vjeçari mund të bëhet lojtar i Al Shababit. De Gea mbylli kontratën me "dajtë e kuq" më 30 qershor të vitit të kaluar dhe që nga ajo kohë është pa ekip. Duke mos luajtur asnjë ndeshje. Është përfolur disa herë se ai mund të luajë në Arabi, apo në Amerikë dhe Premier Ligë, por ende nuk ka pasur asgjë konkrete. Skuadra e Al Shabab ditë më parë mbylli transferimin me kosto zero nga Sevilla të kroatit Ivan Rakitiq.



## SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

<b>Titulli i vendit të punës:</b>	Ekonomist/e i/e ri/e për Stabilitet Financiar (dy pozita)
<b>Grada e pozitës:</b>	shtatë (7)
<b>Kohëzgjatja e punësimit:</b>	pa afat
<b>Pozita:</b>	e përhershme
<b>Departamenti:</b>	Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Stabilitetit Financiar
<b>Divizioni:</b>	Divizioni për Stabilitet Financiar
<b>Raporton tek:</b>	Udhëheqëses së Divizionit për Stabilitet Financiar

### Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Asiston në implementimin e programin afatshkurtër dhe afatmesëm të punës në fushën e stabilitetit financiar;
- Merr pjesë në përgatitjen e analizave të sektorit financiar me qëllim të arritjes së objektivave përkatëse dhe realizimit të detyrave përkatëse të BQK-së;
- Analizon dinamikat e tregjeve dhe institucioneve financiare, me qëllim të identifikimit të rreziqeve që përbëjnë kërcënime për stabilitetin e sistemit financiar;
- Kontribuon në vlerësimin e rrezikut sistematik, përmes analizimit dhe avancimit të vazhdueshëm të instrumenteve dhe modeleve për vlerësimin e këtij rreziku;
- Kontribuon në definimin e kërkesave për të dhëna të duhura në procesin e hulumtimit duke përfshirë mbledhjen, përpilimin dhe organizimin e të dhënave statistikore relevante për procesin e hulumtimeve;
- Rekomandon dhe kontribuon në çështje të ndryshme me relevancë për fushën e stabilitetit financiar dhe proceset e punës në departament;
- Mbështet bashkëpunimin e nevojshëm me të gjitha palët relevante përkitazi me çështjet e stabilitetit financiar;
- Përbush detyra tjera në bazë të kërkesës së mbikëqyrësit.

### Njohuritë e kërkuara:

- Diplomë bachelor në fushën e ekonomisë, statistikës, matematikës, financës ose disiplina të ngjashme. Niveli pasuniversitar është i dëshirueshëm;
- Përvoja e punës në fushën e analizave të sistemit financiar dhe analizave makroekonomike në institucione financiare, institucione kërkimore apo subjekte tjera me karakter kërkimor është e dëshirueshme;
- Njohuritë dhe shkathtësitë në modelim të dëshirueshme;
- Rrjedhshmëri në gjuhën shqipe dhe njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze.

### Kërkesa të posaçme:

- Aftësi shumë të mira analitike, të shkruara dhe në të folur;
- Vet-iniciativë, aftësi të zgjidhjes së problemeve, bashkërendimit dhe punës në grup.

### Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

### Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **13 shkurt 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)



## OGLAS O SLOBODNOM RADNOM MESTU

<b>Naziv radnog mesta:</b>	Mlađi ekonomista za finansijsku stabilnost (dve pozicije)
<b>Stepen pozicije:</b>	sedam (7)
<b>Trajanje zaposlenja:</b>	bez roka
<b>Pozicija:</b>	stalna
<b>Odeljenje:</b>	Odeljenje za ekonomske analize i finansijsku stabilnost
<b>Odsek:</b>	Odsek za finansijsku stabilnost
<b>Izveštava:</b>	Rukovodiocu Odeljenja za finansijsku stabilnost

### Sažetak dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže u realizaciji kratkoročnog i srednjoročnog programa rada u oblasti finansijske stabilnosti;
- Učestvuje u pripremi analiza finansijskog sektora u cilju postizanja relevantnih ciljeva i izvršavanja relevantnih zadataka CBK-a;
- Analizira dinamiku finansijskih tržišta i institucija, kako bi se identifikovali rizici koji predstavljaju pretnju stabilnosti finansijskog sistema;
- Doprinosi proceni sistemskog rizika, kroz analizu i kontinuirano unapređenje instrumenata i modela za procenu ovog rizika;
- Doprinosi definisanju zahteva za odgovarajućim podacima u procesu istraživanja, uključujući prikupljanje, kompilaciju i organizaciju statističkih podataka relevantnih za proces istraživanja;
- Preporučuje i doprinosi različitim pitanjima od značaja za oblast finansijske stabilnosti i procesa rada u odeljenju;
- Podržati neophodnu saradnju sa svim relevantnim stranama u vezi sa pitanjima finansijske stabilnosti;
- Obavlja i druge poslove na zahtev supervizora.

### Potrebna znanja:

- Diploma bachelor iz ekonomije, statistike, matematike, finansija ili sličnih disciplina. Postdiplomski nivo je poželjan;
- Poželjno radno iskustvo u oblasti analize finansijskog sistema i makroekonomske analize u finansijskim institucijama, istraživačkim institucijama ili drugim subjektima istraživačkog karaktera;
- Poželjna znanja i veštine modeliranja;
- Tečno poznavanje albanskog jezika i odlično poznavanje engleskog jezika.

### Posebni zahtevi:

- Veoma dobre analitičke, pismene i govorne veštine;
- Samoinicijativnost, veštine rešavanja problema, koordinacije i timskog rada.

### Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK-a za apliciranje;
- Propratno pismo (motivaciono) u kojem je naglašeno interesovanje za ovu poziciju;;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti službeno priznate/ nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

### Postupak apliciranja:

- Krajni rok za apliciranje je **13 februar 2024**.
- Apliciranje se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko službene internet stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Ostali oblici za prijavu neće se uzeti u obzir.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti preko službene internet stranice: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)



## RISHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

<b>Titulli i vendit të punës:</b>	Mbikëqyrës i Lartë Pensioneve dhe Tregjeve
<b>Niveli i gradës:</b>	pesë (5)
<b>Kohëzgjatja e punësimit:</b>	pa afat
<b>Pozita:</b>	e përhershme
<b>Divizioni:</b>	Divizioni i Mbikëqyrjes Pensionale dhe Tregjeve
<b>Raporton tek:</b>	Udhëheqësi i Divizionit të Mbikëqyrjes Pensionale dhe Tregjeve

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Udhëheqë ekipin e mbikëqyrësve në ekzaminimet në vend në Fondet Pensionale,
- Planifikon, koordinon dhe udhëheqë resurset dhe kohën e nevojshme për ekzaminimet në vend në Fondet Pensionale,
- Kryen ekzaminimet në vend, në shqyrtimin e raporteve dhe vlerësimin e raporteve të raportuara në BQK, përcaktimin e fushëveprimit, planifikimin e resurseve dhe kohës së ekzaminimeve në vend në Fondet Pensionale,
- Përcakton fushëveprimin e ekzaminimeve në vend dhe identifikon masat detyruese pas ekzaminimit, ndaj Fondeve Pensionale,
- Përpilon raportet e ekzaminimit dhe vlerëson përshtatshmërinë e draft raporteve të përgatitura nga mbikëqyrësit pensioneve për fushat e tyre të përgjegjësisë, në ekzaminimet në vend në Fondet Pensionale,
- Monitoron zbatimin e rekomandimeve, kërkesave nga ekzaminimet në vend, masave detyruese të shqiptuara ndaj Fondeve Pensionale,
- Përgatit strategjitë mbikëqyrëse komform profilin të rrezikut të fondeve pensionale, dhe rekomandon udhëheqësin e divizionit për shpeshësinë dhe fushëveprimin e ekzaminimeve të fokusuar në vend,
- Në rolin e mbikëqyrësit përgjegjës pas ekzaminimit në bashkëpunim me udhëheqësin e divizionit, përgatit dhe vlerëson performancën e punës së mbikëqyrësve pjesëmarrës në ekzaminim,
- Të përpiloj raport mbi gjendjen e mjeteve të investuara të tregjet financiare dhe performancën e tyre, duke përfshirë kthimin nga investimet dhe çështjet tjera,
- Ndihmon në përpilimin e politikave mbikëqyrëse, rregullore dhe procedurave tjera të punës,
- Detyra tjera të përcaktuara periodikisht nga Udhëheqësi i Divizionit të Mbikëqyrjes Pensioneve dhe Tregjeve,

### Edukimi:

- Të ketë të kryer fakultetin në fushën e ekonomisë, financave, kontabilitetit, matematikës, ose të ngjashme;
- Preferohet kualifikim të nivelit "Kontabilist i Çertifikuar" në institucionet përkatëse;
- Njohuri bazike të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar;
- Të ketë njohuri të mira rreth operimit të fondeve pensionale, tregjet financiare dhe instrumenteve financiare;
- Njohuri të mira për kuadrin ligjor, rregulloret të zbatueshme ndaj fondeve pensionale për të vlerësuar përshtatshmërinë e tyre;
- Njohuri të vlerësimit dhe përdorimit të aplikacioneve të nevojshme kompjuterike;
- Preferohet njohuri të mira të Gjuhës Angleze;

### Përvoja e punës:

- Të ketë minimum 3 vjet përvojë pune në njërin nga fushat e cekura: financa; kontabilitet; auditim; menaxhim të riskut; menaxhim të investime; kontrolla të brendshme. Ndërsa preferohet përvoja e punës në institucionet financiare dhe kompanitë e auditimit.

### Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

### Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **13 shkurt 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org).



## PONOVNO OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

<b>Naziv radnog mesta:</b>	Viši nadzornik za penzije i tržišta
<b>Stepen:</b>	pet (5)
<b>Trajanje radnog odnosa:</b>	na neodređeno vreme
<b>Položaj:</b>	stalni
<b>Divizija:</b>	Divizija za nadzor penzija i tržišta
<b>Izveštava:</b>	Rukovodiocu Odeljenja za nadzor penzija i tržišta

### Dužnosti i odgovornosti:

- Rukovodi timom supervizora na kontrolama na licu mesta u penzionim fondovima;
- Planira, koordinira i upravlja resursima i vremenom potrebnim za kontrole na licu mesta u penzionim fondovima;
- Vrši kontrole na licu mesta, pregleda izveštaje i procenjuje izveštaje prijavljene CBK-u, određujući obim, planiranje resursa i vreme kontrole na licu mesta u penzionim fondovima;
- Definiše delokrug kontrola na licu mesta i identifikuje obavezujuće mere nakon kontrole, prema penzionim fondovima;
- Sastavlja izveštaje o kontrolama i ocenjuje prikladnost nacrtane izveštaja koje pripremaju penzioni supervizori za svoje delokrug rada, na kontrolama na licu mesta u penzionim fondovima;
- Prati sprovođenje preporuka, zahteva iz kontrola na licu mesta, obaveznih mera izrečenih penzionim fondovima;
- Priprema strategije nadzora u skladu sa profilom rizika penzionih fondova i preporučuje rukovodiocu odseka učestalost i obim kontrola fokusiranih na licu mesta;
- U ulozi supervizora odgovornog nakon kontrole u saradnji sa rukovodiocem odseka, priprema i ocenjuje radni učinak supervizora koji učestvuju u kontroli;
- Sastavlja izveštaj o stanju uloženi sredstava finansijskih tržišta i njihovom poslovanju, uključujući povrat od ulaganja i druga pitanja;
- Pomaže u izradi nadzornih politika, propisa i drugih radnih procedura;
- Ostale dužnosti koje periodično utvrđuje rukovodilac Odseka za nadgledanje penzija i tržišta hartija od vrednosti.

### Obrazovanje:

- Da ima završen fakultet iz oblasti ekonomije, finansija, računovodstva, matematike ili slično;
- Poželjna je kvalifikacija nivoa „Sertifikovani računovođa“ u relevantnim institucijama;
- Osnovno poznavanje međunarodnih standarda finansijskog izveštavanja;
- Da dobro poznaje rad penzionih fondova, finansijskih tržišta i finansijskih instrumenata;
- Dobro poznavanje pravnog okvira, propisa koji se primenjuju na penzione fondove za procenu njihove podobnosti;
- Poznavanje procene i korišćenja potrebnih računarskih aplikacija;
- Poželjno je dobro poznavanje engleskog jezika;

### Radno iskustvo:

- Imati minimalno 3 godine radnog iskustva u jednoj od navedenih oblasti: finansije; računovodstvo; revizija; upravljanje rizikom; upravljanje investicijama; interne kontrole. Dok je poželjno radno iskustvo u finansijskim institucijama i revizorskim firmama.

### Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK za prijavu;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem se ističe interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrde poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje funkcije i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata o zaštiti podataka o ličnosti).
- Izveštaj Fonda penziona štednje Kosova (Trust)** za relevantni period, ili poresku potvrdu iz Poreske administracije (PAK) u slučajevima kada se izveštaj iz Trusta zakonski ne primenjuje.
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

### Postupak prijave:

- Zadnji rok za podnošenje prijave je **13 februar 2024**.
- Prijava se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Ostali oblici za prijavu neće se uzeti u obzir.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti putem službene veb stranice: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “aDvantazh Media Solutions” Sh.P.K. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812105139 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “aDvantazh Media Solutions” D.O.O. od Kosova Polje, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812105139 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform all customers that the limited liability “aDvantazh Media Solutions” L.L.C. with headquarters Fushë Kosova, has come to the decision to quit its business: 812105139 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave/ Department of Environment Protection and Waters/  
Departament za Zaštitu Sredine i Voda

**NJOFTIM**

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka pranuar kërkesën dhe Raportin për VNM, si dhe dokumentacionin përcjellës të Kompanisë “LAB - OIL” Sh.p.k. – Preoc, Graçanicë me nr. prot.: 23/7409/711/DMMU për Pëlqim Mjedisor për Fabrikën e Pet Koksit dhe Impiantin për Deponimin e Koksit, Graçanicë.

Prandaj, në kuadër të procedurave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe shqyrtimin e Raportit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për të cilin është bërë kërkesa për pëlqim Mjedisor, duhet të mbahet debati publik.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e Njofton Kompaninë “LAB - OIL” Sh.p.k. – Preoc, Graçanicë se duhet të bëjë organizimin për mbajtjen e **debatit publik** për Raportin e VNM-së, duke u bazuar në Neni 16. të Ligjit Nr. 08/L-181 për VNM.

Në bazë të nenit 9, paragrafët 4. dhe 5. të Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr. 18/2015 për Informimin, pjesëmarrje të publikut dhe palëve të interesuara në procedurat e vlerësimit të ndikimit, njoftimin për planin dhe organizimin e mbajtjes së debatit publik duhet të dërgohet në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të njoftimit nga MMPHI, në të kundërtën nëse nuk respektohet afati ligjor i lartshënuar kërkesa e kompanisë “LAB - OIL” Sh.p.k. – Preoc, Graçanicë do të ndërpritet procedura e shqyrtimit për pëlqim mjedisor.

Me respekt

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  [www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT****SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- N.T.SH. “E&B ENGINEERING” shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 70650894.

- Shkurte Hasani, shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Jusuf Rexha”.

- D.P.T. KIOSK TE BUKI, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 810559148.

- Suela Osmani shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Xheladin Deda”.

- Hyrjet Boshnajku nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl I,II, të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Qëndresa Ademi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë Sh,F,M.U. “Isa Boletini” Osek, K.K Gjakovë nga kl, I-V dhe VI-IX.

- Gjon Gojani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kll. 10.11.12.13 dhe diplomën e Sh.M.E. “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Leonit Qevani nga Damjani KK Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M.E. “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Fatmir Kabashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU “Dëshmorët e Kabashit” Korishë.

- Erkan Krasniqi shpall te pavlefshme diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.

- Liridon Morina shpall te pavlefshme diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



# TRADITË QË NGA 1992

